



REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVA

GJYKATA THEMELORE PEJË

Numri i lëndës: 2022:004349

Datë: 31.10.2023

Numri i dokumentit: 04856560

NË EMËR TË POPULLIT

P.nr.160/22

GJYKATA THEMELORE PEJË, Departamenti i Përgjithshëm, gjyqtari i vetëm gjykues Leon Përlaska me procesmbajtëse Shpresa Kërnye në çështjen penale kundër të pandehurave T. B. për shkak të veprës penale Lëndim i lehtë trupor nga neni 185 par.2 dhe par.1 nënpar 1.4 të KPRK-së dhe V. H. për shkak të veprës penale Lëndim i lehtë trupor nga neni 185 par.1 nënpar 1.4 të KPRK-së, të akuzuara sipas aktakuzës së Prokurorisë Themelore në Pejë- Departamenti i Përgjithshëm PP/II.nr.5/2022 të datës 22.02.2022, në seancën publike të shqyrtimit fillestar të mbajtur me datë 16.10.2023 në prezencë të prokurorit së shtetit Dorjan Juniku, të pandehurës V. H. dhe të pandehurës T. B. dhe mbrojtësit të caktuar sipas detyrës zyrtare av.Gëzim Baloku, të njëjtën ditë mori dhe shpalli ndërsa me datë 27.10.2023 përpiloi këtë:

AKTGJYKIM

Të pandehurat:

- T. B. , e lindur me ....., ne Pejë, i bija e B., dhe i nenës M., e gjinisë K., me nr personal ....., ka kryer shkollën fillore, e pa punë, e gjendjes së dobët ekonomike rast social, e martuar nënë e katër fëmijëve, , shqiptar, shtetas i R. së Kosovës.
- V. H., i lindur me ....., ne Pejë, ku dhe e jeton, i bija e B., dhe M., e gjinisë K., me nr personal ....., ka kryer shkollën fillore, me profesion filizerk, e gjendjes së mesme ekonomike , e martuar, nënë e katër fëmijëve , shqiptare, shtetas i R. së Kosovës.

SHPELLËN FAJTORE

Për shkak se :

- E pandehura T. B. ,

I. Me datën 09.01.2022 rreth orës 14:00, në rr. “K. e B.t”K- Peje, me mjete me te cilin mund të shkakton lëndim te rënda trupor tjetrit i shkakton lëndime të lehta trupore me pasojë dëmtime të

përkohshme për shëndetin dhe atë të dëmtuarës *R. H.*, në atë mënyrë që, në kohën e lartcekur pasi e dëmtuara kishte shkuar tek lokali i të pandehurës në mes tyre kishte filluar një fjalosje rreth rregullimit të flokëve, ku në ato momente e pandehurave T. e kap për krahi dhe flokëve e qet jashtë lokalit, dhe pas disa minuta e pandehura T. së bashku me të pandehurën si në dispozitivin II i vihen pas dhe me të arritur tek hoteli “K.” e pandehura T. në mënyrë të vrullshëm dhe me një qeramikë fillon ta godas në disa here në kokë gjër sa e rrezon dhe pasi e shtrin për toke e godet me kokë për pllaka të betoni pa ndërpre ku si pasojë e këtyre goditjeve e dëmtuara pëson ndrydhje (mbretje) të indeve të buta të kokës, të regjionit të kafazit të kraharorit dhe të regjionit të vithes (gluteusit) të kofshës të këmbës së djathtë dhe si të tilla bëjnë pjesë në lëndime të lehta trupore me pasojë të përkohshme shëndetësore.

- me këtë ka kryer veprën penale “Lëndim i lehtë trupor” nga neni 185 par. 2 dhe me par. 1 nën par. 1.4 të KPRK-së.
- E pandehura V. H.,

II. Me datën 09.01.2022 rreth orës 14:00, në rr. “K. e B.”K- Peje, tjetrit i shkakton lëndime të lehta trupore me pasojë dëmtime të përkohshme për shëndetin dhe atë të dëmtuarit *R. H.*, gjersa e pandehura si në dispozitivin numër I ishte duke e goditur të dëmtuarit e cila ishte e shtrirë për toke aty shkon e pandehura V. i hyp përmbi dhe me shkelma e godet në pjesët e ndryshme trupit duke i shkaktuar lëndime trupore si ndrydhje (mbretje) të indeve të buta të kokës, të regjionit të kafazit të kraharorit dhe të regjionit të vithes (gluteusit) të kofshës të këmbës së djathtë dhe si të tilla bëjnë pjesë në dëmtime të lehta trupore me pasojë të përkohshme shëndetësore.

- me këtë ka kryer veprën penale “Lëndim i lehtë trupor” nga neni 185 par. 1 nën par. 1.4 të KPRK-së.

Prandaj në kuptim të nenit 364 të Kodit të Procedurës Penale të Republikës së Kosovës dhe nenit 38, 39, 40, 42, 46, 48, 49, 69 dhe 70 të Kodit Penal të Republikës së Kosovës ( O6/L-074):

## GJYKON

- Të pandehurës T. B. i shqipton:

DËNIM ME BURGIM TË KUSHTËZUAR në kohëzgjatje prej 1 (një) viti, i cili dënim nuk do të ekzekutohet nëse e dënuara nuk do të kryej veprën tjetër penale brenda periudhës verifikuese prej dy (2) vitesh, që do të llogaritet nga data e plotfuqishmërisë së këtij aktgjykimi.

- Të pandehurës V. H. i shqipton:

DËNIM ME BURGIM TË KUSHTËZUAR në kohëzgjatje prej 6 (gjashtë) muajsh, i cili dënim nuk do të ekzekutohet nëse e dënuara nuk do të kryej vepër tjetër penale brenda periudhës verifikuese prej 1 (një) vitesh, qe do të llogaritet nga data e plotfuqishmërisë së këtij aktgjykimi.

- E pandehura T. B. lirohet nga shpenzimet e procedurës, të cilat shpenzime mbeten në barrën e mjeteve buxhetore të gjykatës.
- Obligohet e dënuara V. H. që në emër të paushallit gjyqësor të paguaj shumën prej 20 euro dhe në emër të fondit për kompensimin e viktimave të krimit të paguaj shumën prej 20 euro, të gjitha këto në afat prej 15 ditësh nga dita e plotfuqishmërisë së këtij aktgjykimi, nën kërcënimin e përmbarimit me detyrim.
- Kërkesë pasurore juridike nuk pati .

#### ARSYETIM

- Historiku i çështjes dhe vendimi ne lidhje me fajësinë;

Prokuroria Themelore në Pejë-Departamenti i Përgjithshëm me datë 22.02.2022 pranë kësaj gjykate ka ngritur aktakuzën PP/II.nr.5/22, kundër të pandehurave T. B. për shkak të veprës penale Lëndim i lehtë trupor nga neni 185 par.2 dhe par.1 nënpar 1.4 të KPRK-së dhe V. H. për shkak të veprës penale Lëndim i lehtë trupor nga neni 185 par.1 nënpar 1.4 të KPRK-së.

Kjo gjykatë me datë 16.10.2023 e mbajti seancën e shqyrtimit fillestar në të cilën prezantuan prokurori i shtetit Dorjan Juniku, e pandehur V. H. dhe e pandehura T. B. me mbrojtësin e caktuar sipas detyrës zyrtare av.Gëzim Baloku, në të cilën seancë te pandehurat u deklaruan se e pranojnë fajësinë për veprat penale që u vihen në barrë.

Pas marrjes së mendimit të prokurorit të shtetit dhe mbrojtësit në kuptim të nenit 242 par.2 dhe 6 të KPPRK-së gjykata vendosi që të aprovoj pranimin e fajësisë të bërë nga të pandehurat, pasi që është e qartë se e kuptuan natyrën dhe pasojat e pranimin të fajit, pranimi i fajësisë bëhet vullnetarisht, pranimi mbështetet në faktet e çështjes që përmban aktakuza dhe provat e pranueshme që e mbështetin aktakuzën dhe se aktakuza nuk përmban shkelje të qarta ligjore ose gabime faktike.

Pas aprovimit të pranimit të fajësisë nga ana e gjykatës, prokurori i shtetit deklaroi “ Me qenë se të pandehurat T. B. dhe V. H., e pranuan fajësinë konform nenit 242 të KPPRK-së, duke kuptuar natyre dhe pasojat e pranimit të fajësisë, pranimin e fajësisë e bënë vullnetarisht dhe në mbështetje të fakteve të çështjes që përmban aktakuza, nga Gjykata kërkoj që të njëjtat ti shpall fajtorë ti dënoj sipas ligjit si dhe ti obligoj në paguarjen e shpenzimeve të procedurës penale, ndërsa me rastin e përcaktimit të llojit dhe lartësisë së dënimit pranimin e fajësisë ta vlerësoj si rrethanë lehtësuese, kurse në kuptim të dispozitave ligjore të nenit 70 të KPPRK-së, për të pandehurën T. B. , si rrethanë rënduese të vlerësoj shkallën lartë të dashjes dhe prezencën e dhunës në kryerjen e veprës penale, nga se këtu e p pandehura Teuta duke mos u kënaqur me tërheqje flokësh dhe largim nga lokali, e njëjta pas këtyre veprime i kishte shkuar pas të dëmtuarës dhe pasi që e kishte zënë te hoteli “Unit” në mënyrë të vrullshme dhe me një qeramikë kishte filluar ta godas disa herë në kokë, dhe pasi e kishte rrezuar të njëjtën në tokë, e kishte goditur në kokë për pllaka të betonit”.

Mbrojtësi i të pandehurës T. B., dekonon: "Me qenë se pandehura e a pranuar fajësie do të iremi me rrethanat që caktojnë llojin dhe lartësinë dënimit, mendoj se pranimi i fajësisë është rrethanë lehtësuese që do të ndikoj në dënim, ka edhe rrethana tjera lehtësuese siç janë se e dëmtuara ka shkuar në lokal të tyre ku ka provokuar, fyer dhe sharre dhe duke pas parasysh natyrën e pandehurës që vetë ka probleme psikike dhe k dy fëmijë me nevoja të posaçme dhe varet nga ndihma sociale, donë me thonë ka qanë moment i keq për te dhe ka reaguar ashtu siç ka reaguar, mirëpo e njëjta ka pa gabimin e vetë dhe i ka dërguar njerëzit tek e dëmtuara për mu pajtu, janë pajtu, i ka ndihmua në blerjen e të gjitha medikamenteve si dhe i ka dhënë para kesh po si ndihmë, kështu që unë mendoj se me qenë se e njëjta ka qenë e sinqertë ku do të njoftonte një dënim me kusht, e në të kundërtën do të krijonim edhe një probleme se nuk ka kush ti këqyre fëmijët e saj me nevoja të posaçme kështu që nuk do të kishim me arrit asgjë me ketë, sepse është penduar, janë pajtuar dhe e ka kompensuar të dëmtuarën, propozoj ti shqiptohet dënim me kusht".

E pandehura T. B. , deklaron "Pajtoje me mbrojtësin në tërësi, shtoj se e kam pas historinë e hapur në spital, tri ditë para se me ndodhë ky rast unë kam dal prej spitalit të psikiatrisë, e kam ba pa kontrollin teme se nuk e kisha bo kurr, jam e pendime dhe nuk ka me ndodhë ma kurrë ky send".

E pandehura V. Ha., deklaron "Është rasti i parë që ka ndodhë në jetën time me pas problem me dikë, pendohem në maksimum, kam kërku falje të dëmtuarës dhe kërkoj prapë dhe ju siguroj se nuk ka me ndodhë ma asnjëherë ky send.

- Vendimi lidhur me dënimin;

Gjykata kur vendosi të shqiptoj dënimin si në dispozitiv të këtij aktgjykimi u bazua në dispozitat 38, 39, 40, 42, 46, 48, 49, 69 dhe 70 të Kodit Penal të Republikës së Kosovës ( 06/L-074) dhe atë duke vlerësuar rrethanat lehtësues dhe rënduese të çështjes.

Përcaktimi i dënimit me burgim prej 1 (një) viti për të pandehurën T. B. dhe dënimit prej 6 (gjashhtë) muajsh për të pandehurën V.H. u bë duke filluar matjen e dënimit nga pikënisja e dënimit, që sipas praktikës gjyqësore dhe udhëzuesit të Gjykatës Supreme, pikënisje është pika e mesme e minimumit dhe maksimumit të dënimit për veprën penale përkatëse.

Pastaj, duke vlerësuar rrethanat rënduese dhe lehtësuese të rastit, duke bërë peshimin e tyre si dhe duke aplikuar dispozitat ligjore përkatëse për matjen e dënimit, gjykata vendosi për dënimin me burgim të shqiptuar si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

Duke i analizuar faktet e çështjes, gjykata erdhi në përfundim se në lidhje me të pandehurat nuk kemi fare rrethana rënduese, ndërsa si rrethana lehtësuese gjykata e gjeti pranimin e fajësisë të bërë në seancën e shqyrtimit fillestar, ku duke u nisur nga këto rrethana dhe në kuptim të nenit 38 dhe 42 të KPRK-së gjykata vendosi që ndaj të pandehurave të shqiptoj dënimin si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

Kur u vendos për kushtëzimin ekzekutimit të dënimit me burgim gjykata u bazua në nenin 46, 48 par.1 dhe 2 dhe 49 par.1 dhe 3 të KPRK-së.

Gjykata vlerësoj se me shqiptimin e dënimit më kusht ndaj të pandehurve do të arrihet të realizohet në tërësi qëllimi i dënimit, pasi që ky dënim do të ndikoj në rehabilitimin e të pandehurve, në parandalimin e personave të tjerë nga kryerja e veprave penale dhe në mënyrë të arsyeshme shpreh gjykimin shoqëror për veprimet e kryerësit. Tërheqja e vërejtjes të pandehurve se nëse në periudhën verifikuese si në dispozitiv të aktgjykimit do të kryejnë veprë tjetër penale ndaj tyre do ekzekutohet dënimi me burgim si në dispozitiv të aktgjykimit, është një paralajmërim serioz që të parandaloj të pandehurat në kryerjen e veprave penale në të ardhmen.

Gjykata e shqiptoj dënimin më kusht në përputhje me nenin 49 par.1 të KPRK-së ku thuhet “Dënimi me kusht mund t’i shqiptohet kryesit të veprës penale për të cilën me ligj është paraparë

dënimi me burgim deri në pesë (5) vjet”, e në këtë rast siç u përshkrua me lartë për veprat penale që janë shpallur fajtores dy të pandehurat është paraparë mundësia e shqiptimit të dënimit me me gjobë ose me burgim deri në tre (3) vjet.

Gjykata është bindur se dënimi i shqiptuar të pandehurve është në përputhshmëri të plotë me qëllimin e dënimit të përcaktuar në nenin 38 të KPRK-së dhe se ky dënim do të parandalojë kryesit nga kryerja e veprave penale në të ardhmen dhe të bëjë rehabilitimin e tyre, do të parandalojë personat e tjerë nga kryerja e veprave penale te ngjashme dhe shprehë gjykimin shoqëror për veprën penale të kryer nga të pandehurit.

Vendimi mbi shpenzimet e procedurës penale për paushallin gjyqësor u mor në kuptim nenit 450 par.1 dhe par.2 nën paragrafi 2.6 dhe nenin 453 par.1 të KPPK-së.

Vendimi lidhur me taksën për kompensimin e viktimave të krimit, u mor në bazë të nenit 36 par.3 pika 1 të Ligjit 08/L-109, për kompensimin e viktimave të krimit.

Kërkesë pasurore juridike nuk pati, siç parashihet nenin 458 par.1 të KPRK-së, si rrjedhojë gjykata nuk vendosi për kompensim të dëmit e as nuk i udhëzoi në kontest civil të dëmtuarat.

Andaj, duke u mbështetur në fakte e parashtruara dhe dispozitat ligjore nga neni 364 dhe 369 të KPPRK-së u vendos si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

**GJYKATA THEMELORE PEJË**  
Departamenti i Përgjithshëm/Divizioni Penal  
P.nr.160/22, me datë 27.10.2023

Procesmbajtësja  
Shpresa Kërnje

Gjyqtari i vetëm gjykues  
Leon Përlaska

**KËSHILLË JURIDIKE:**

Kundër këtij aktgjykimi pala e pakënaqur ka të drejtë ankese në afat prej 30 ditësh nga pranimi i të njëjtit, ankesa paraqitet në këtë gjykatë për Gjykatën e Apelit në Prishtinë.